

Akademia e të Drejtave të Njeriut dhe Minoriteteve
Human Rights & Minority Rights Academy
Online & në Voskopojë
27-31 tetor 2020

Format aplikimi

Afati i dorëzimit: 23 tetor 2020

KUJDES: Kjo thirrje për aplikim është vetëm për të diplomuarit e Akademisë ndër vite (2012-2019)

Akademia e të Drejtave të Njeriut dhe Minoriteteve është një aktivitet i përvitshëm, që prej vitit 2012, i organizuar nga Grupi Shqiptar i të Drejtave të Njeriut (GSHDNJ), në bashkëpunim të ngushtë dhe me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri. Këtë vit, organizimi i Akademisë mundësohet përmes projektit **“Mbështetje për parlamentin dhe edukimin qytetar në Shqipëri”**, i cili mbështetet nga qeveria zvicerane dhe zbatohet nga Prezenca e OSBE-së dhe Instituti Demokratik Amerikan, në bashkëpunim të ngushtë me Kuvendin e Shqipërisë.

Akademia mundëson njohuri bazë mbi të drejtat në shoqërinë demokratike, çfarë duhet të dinë dhe si duhet të veprojnë të rinjtë për të qenë të vlefshëm në aktivizmin e tyre për të respektuar të drejtat e njeriut dhe për t’iu dhënë zgjidhje problemeve.

Për shkak të kufizimeve, si rrjedhojë e pandemisë COVID-19, programi i Akademisë 2020 do të zhvillohet përmes një kombinimi të leksioneve online dhe atyre në terren. Aktiviteti i Kuvendit të Shqipërisë gjatë periudhës së pandemisë, roli i medias në garantimin e transparencës së institucioneve nën masat kufizuese, reforma zgjedhore dhe edukimi i zgjedhësve në prag të zgjedhjeve të përgjithshme të vitit 2021, pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje, angazhimi i shoqërisë civile në zhvillimet demokratike në vend gjatë COVID-19-s, barazia gjinore dhe të drejtat e pakicave janë disa nga temat qendrore të këtij viti.

Temat trajtohen në mënyrë ndërvepruese nga lektorë shqiptarë dhe të huaj.

CV-ja juaj të dërgohet bashkëngjitur këtij formulari.

Aplikimet duhen dërguar në:

denada.janaqi@osce.org;

el.ballauri@gmail.com;

eqlantina.reka@osce.org

Titulli i emailit: **Akademia e të Drejtave të Minoriteteve 2020 / Emër Mbiemër**



Supported by

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Formular aplikimi
Akademia e të Drejtave të Njeriut dhe Minoriteteve
Online & në Voskopojë, 27-31 tetor 2020

Emër: Mbiemër:
Moshë:
Gjinia:
Institucioni/Organizata:
Email; Telefon:
Shkolla/Universiteti/Organizata:

Cilat nga temat e përmendura më sipër do të donit të ishin në fokus të Akademisë Voskopojë 2020? Pse? Ju lutemi, jepni përgjigjen tuaj më poshtë (jo më shumë se 200 fjalë):

Rregullat e trajnimit:

1. Të respektohet orari dhe të ndiqen të gjitha sesionet, sipas programit;
2. Të respektohet secili pjesëmarrës pavarësisht racës, prejardhjes, gjinisë, orientimit seksual apo besimit fetar;
3. Të respektohen rregullat që do të vendosen në fillim të trajnimit nga organizatorët.

KUJDES !

Në rast mosrespektimi të rregullave, pjesëmarrësi duhet të largohet nga trajnimi dhe të paguajë të gjitha shpenzimet që lidhen me 5 ditët e trajnimit.

Vlerësimi final për zhvillimin e aktivitetit fizik në Voskopojë do të merret bazuar në ecurinë e situatës të COVID-19-s në Shqipëri.

Unë, aplikanti, për të marrë pjesë në trajnimin Akademia e të Drejtave të Njeriut dhe Minoriteteve, deklaroj se bie dakord me rregullat e sipërpërmendura dhe, në rast mospërbushjeje të tyre, do të shlyej të gjitha detyrimet që lindin si pasojë e mosrespektimit të rregullave të vendosura.

Emër Mbiemër: _____



Supported by
Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC